



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE TË GJELBËRIMIT, HIGJENËS DHE
MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më .01.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PER PROCEDUREN E HAPUR E THJESHTUAR
ME MJETE ELEKTRONIKE**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**Blerje kamionçina**”, me burim financimi nga Ndërmarrja e Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
“**Kamionçina**” 34136200-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 040 000 (katër milion e dyzetë mijë) **lekë pa TVSH dhe 4 848 000** (katër milion e tetëqind e dyzetë e tetë mijë) **lekë me TVSH**, vënë në dispozicion nga buxheti i Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve të Gjellbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

1.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **1 500 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së për llogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, në të cilin gjëjmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1.** *Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi der në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/c:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e Thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për

Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **800 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; ose /dhe,
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në

vlerën sa 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve të Gjelbërimit, Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike Fier, me Urdhërin nr.1881 prot datë 19.11.2024 në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

***Shenim:** Në cdo rast kur në specifikimet teknike dhe preventive mund të jetë përdorur si referencë emri i ndonjë marke apo emri të vecantë, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo / dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

***Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”*

Njësia e prokurimit: